

Sinjalizime

# Ekskluzive| Plumbi “qorr” çan çatinë dhe përfundon brenda dhomës së një shtëpie në Skenderaj – dyshohet se erdhi nga AK-47



Sinjali.com

10 Gusht 2026 09:51



**Një familje në Skenderaj është përballur me një situatë të rrezikshme mbrëmjen e së dielës, pasi një predhë ka depërtuar përmes çatisë dhe ka përfunduar brenda një dhome të shtëpisë, raporton Sinjali.**

Sinjali mëson se rasti ka ndodhur më 9 gusht, rreth orës 22:30, në rrugën “Sala e Hamit Jashari”, ndërsa rastin në Polici e ka raportuar A. H. rreth 51-vjeç.

Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, predha ka depërtuar fillimisht përmes çatisë së shtëpisë dhe më pas ka përfunduar brenda një dhome banimi në katin e tretë.

Fatmirësisht, në momentin e incidentit askush nuk është goditur dhe nuk raportohet për persona të lënduar.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë patrulla policore, hetuesit dhe Krim-teknika, të cilët kanë kryer ekzaminimin e vendit dhe kanë sekuestruar predhën si provë materiale.

Sipas të dhënave të rastit, dyshohet se predha është e kalibrit 7.62 mm dhe mund të jetë shkrepur nga një AK-47.

Për momentin mbetet mister se nga është shtënë dhe kush e ka shkrepur, pasi Policia ende nuk ka identifikuar ndonjë person të dyshuar.

Me vendim të Prokurorit të Shtetit, rasti është iniciuar si “*Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm*” dhe hetimet po vazhdojnë.

**Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.**

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***

***/GazetaSinjali/***

plumbi

Policia

shtëpia

Skënderaj

## Të tjera:



**Policia e Kosovës pajiset me 15 vetura të reja hibride për policët e lagjes**

**Kosovë**



**KFOR nis ndryshimin e sigurisë në Manastirin e Deçanit, përfshihet gradualisht Policia e...**

**Kosovë**



**Ekskluzive | Breshëri plumbash në një ndërtesë në Mitrovicë – qëllohet nga dy anët, d...**

**Sinjalizime**



**Ahengu familjar në Podujevë shoqërohet me të shtëna – 51-vjeçari pranon se shtiu disa...**

**Sinjalizime**



**Të shtëna në aheng familjar në Podujevë – 27-vjeçari pranon para Policisë se shtiu,...**

**Sinjalizime**



**Ekskluzive | Kanosje ndaj ish-gruas te “Dukagjini Residence” – Policia kap të dyshuari...**

**Sinjalizime**



**Ekskluzive| Rrahje për fëmijët në Han të Elezit: Tre burra sulmojnë 55-vjeçarin – njëri ikën ed...**

**Sinjalizime**



**Ekskluzive | Rrahje në trafik në Llapushnik – sulmohet një zyrtar policor jashtë detyre d...**

**Sinjalizime**

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



### Lajme

Zgjedhjet 2026  
Kosovë  
Shqipëri  
Rajon  
Diasporë  
Evropë  
Botë

### Aktualitet

Politikë  
Drejtësi  
Siguri  
Shëndetësi  
Arsim  
Sociale

### Hulumtime

Ekskluzive  
Profile  
Skandaloze

### Ekonomi

Prodhime Vendore  
Financa  
Biznes

### Sport

Botërori 2026  
Futboll  
Basketboll  
Sporte Luftarake  
Sporte të tjera

### Showbiz

Bota e Yjeve  
Modë & Stil  
Bukuri dhe kujdes  
Të tjera

### OP-ED

Analizë  
Kolumne  
Intervistë

### Jetë

Fitness  
Ushqime  
Travel  
Këshilla  
Receta  
Dieta  
Shëndeti

### Kulturë

Film  
Muzikë  
TV & Radio  
Libra  
Art & Dizajn  
Fotografi  
Histori

### Tech & Auto

Teknologji  
Automjete  
Telefona  
Internet  
Lojëra  
Aplikacione

### Fun

Qesharake  
Kuriozitete  
Kuize  
Fakte  
Të tjera